

Njoftim i aplikimeve për licencim

Në zbatim të nenit 40, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, njoftojmë si vijon: shoqëria “GERTI” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë:

- shoqëria “GERTI” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, duke përfshirë dhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit;
- shoqëria “GERTI” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Në mbledhjen e datës 13.07.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e e shoqërisë në secilën prej veprimtarive.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me secilën kërkesë për licencim, brenda 10 (dhjetë) ditëve (nga data 15.07.2026 deri më 24.07.2026) pranë zyrave të ERE-s, në adresën: në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.